

Врз основа на член 55 став 1 од Закон за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 96/2019 и 110/2019) и член 22 став 1 од Закон за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 229/20) и член 3 од Закон за математичко-информатичка гимназија („Службен весник на Република Македонија“ бр. 64/18) министерот за образование и наука ја донесе Наставната програма по *албански јазик и литература* за IV (четврта) година математичко-информатичка гимназија.

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019 dhe 110/2019) dhe neni 22 paragrafi 1 i Ligjit për arsimin e mesëm ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81 /08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 229/20) dhe Neni 3 i Ligjit për gjimnazin matematiko-informatik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/18), Ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi Programin mësimor *për gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV (e katërt) të gjimnazit matematiko-informatik.*

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
për vitin IV

Gjimnazi matematiko-informatik

Shkup, 2023

Emri i programit mësimor	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Lloji i programit mësimor	Obligativ
Vlera e kreditit e programit mësimor	<p>7 ECVET kredite (5 kredite +2 kredite plotësuese)</p> <p>(Numri 5 përcakton kredi të cilat arrihen me pjesëmarrjen në orë të kësaj lëndë mësimore në kuadër të modulit të përgjithshëm arsimor, angazhimin në orë dhe pjesëmarrje në procesin e nxënies dhe mësimin. 2(dy) kredi tjera kanë të bëjnë në pjesëmarrje dhe aktivitete të cilat nxënësit i realizojnë jashtë orëve mësimore në funksion të arritjeve të njohurive të kësaj lëndë mësimore).</p> <p>Dy kredi përfshijnë 50 orë aktivitete të nxënësit (10 orë ushtrime dhe përgatitje për punime me shkrim, 20 orë lexim të veprave dhe lektyrave për përpunim, 20 orë mësim të pavarur (përgatitje të prezantimeve me gojë dhe me shkrim, detyra shtëpie, dhe përgatitje të eseve).</p>
Niveli i kualifikimit	Niveli IV (i katërt)
Viti mësimor	IV (i katërt)
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	3/108
Qëllimet e programit mësimor	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zgjerojnë dhe të përthellojnë njohuritë për gjuhën standarde shqipe si mjet komunikimi; - të zgjidhin, të rezimojnë dhe të zbatojnë dituritë e arritura në kontestin gjuhësor përkatës; - të paraqesin hierarkinë dhe lidhshmërinë e njësive gjuhësore nga fonema deri te fjalia dhe të potencojnë rëndësinë e tyre në komunikimin gjuhësor; - të zbatojnë në të shprehurit me gojë dhe me shkrim rregullat gjuhësore dhe konstrukcionet karakteristike për gjuhën standarde shqipe; - të zbatojnë shkathtësitë për analizë dhe interpretim të pavarur të veprave letrare nga autorë, epoka dhe drejtime të ndryshme;

	<p>- të aftësohen që në mënyrë kritike dhe me argumente të vlerësojnë veprat letrare, situatat problemore, manifestimet shoqërore, kulturore e artistike dhe evenimentet përmes qëndrimeve dhe mendimeve vetjake.</p>
Njësia modulare e programit mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë • Letërsi <p>Shënim: Modulet gjuhësore dhe letrare gjegjësisht përmbajtjet në të dy modulet duhet të kombinohen ndërmjet veti. Me këtë do të arrihet tërësia në raport me qëllimet e përgjithshme të lëndës si dhe arritja e rezultateve të parashikuara sipas kriterëve të dhëna. Çdo orë mësimore edhe më tutje do të ketë qëllimin e vet, i cili në do të kombinohet me përmbajtjet tanimë të mësuara nga njëri apo tjetri modul. Njëkohësisht ju sugjerojmë se orari dhe organizimi i mirë i përmbajtjeve të dhëna do të ndikon në realizimin e orëve, gjegjësisht do të ndikon në suksesin e nxënies në mësim.</p>
Kushtet tekniko-materiale dhe hapësinore	<p>Për arritjen e qëllimeve në lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi duhet që të sigurohen mjete mësimore në kabinete ose klasa, fond i librave për bibliotekë, qasje në internet, pajisje kompjuterike, LCD projektor etj. Për realizim të plotë dhe të suksesshëm të programit mësimor duhet të organizohen edhe aktivitete që e ndërrojnë vendin e realizimit të orës/orëve mësimore (institucione të kulturës, manifestime dhe festivale: letrare, teatrore dhe filmike).</p>
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Programin mësimorë e realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS; -Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.

Njësia modulare: GJUHË				
Nr.rend.	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret e vlerësimit ¹
1	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
1.1.	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë parimet kryesore ku u mbështet normëzimi i shqipes standarde; - të tregojë veçoritë themelore të parimit fonetik; - të tregojë veçoritë kryesore të parimit morfologjik dhe historiko-tradicional - të përcaktojë tiparet kryesore të shqiptimit letrar. 	<p>Shqipja e standardizuar pas Kongresit të Drejtshkrimit</p> <p>Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi</p> <p>Gjuha standarde (letrare) dhe normëzimi i saj</p> <p>Parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde (parimi fonetik, morfologjik, historiko-tradicional etj.)</p> <p>Norma drejtshqiptimore</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Duke paraqitur tekste të larmishme që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre të përditshme, përkatësisht tekste që kanë të bëjnë me profesionin e tyre të ardhshëm nxënësit njihen me variantet e ndryshme joletrare. Me anë pyetjesh të fokusuara nxirren në pah njohuritë e tyre për drejtshkrimin e shqipes standarde.</p> <p>Bëhen ushtrime për të ilustruar me shembuj rëndësinë dhe veçoritë që e karakterizojnë parimin fonetik në të cilin u mbështet shqipja standarde.</p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njihen e përballen me veçoritë, shfaqjet dhe rëndësinë e parimeve të tjera ku u mbështet norma e shqipes standarde.</p> <p>Veprimtaritë mësimore konkretizuese për këto orë përqendrohen te gjuha e folur shqipe (ana tingullore, drejtshqiptimore) dhe përgatiten e realizohen zakonisht me anë mjetesh auditive të konkretizimit me qëllim</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.1.1: të përmendë e të sqarojë parimet ku u mbështet drejtshkrimi i shqipes standarde;</p> <p>1.1.2: të trajtojë e të ilustrojë përdorimin e parimit fonetik te shqipja standarde;</p> <p>1.1.3: të përmendë e të shpjegojë edhe parimin morfologjik e historiko-tradicional;</p> <p>1.1.4: të zbatojë normën e shqipes standarde si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në gjuhën e folur.</p>

¹ Janë përfshirë standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të nxënit sipas të cilëve përcaktohen kriteret e vlerësimit

			<p>ilustrimi të shqiptimit të drejtë normativ në përjasje me format dialektore e jonormative të shfaqjes së tij.</p> <p>Metodat: metoda diakronike, metoda audio vizuale, metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e analizës; metoda e krahasimit.</p>	
1.2	<p>- të tregojë rrugën e përhapjes e të kristalizimit të normës letrare;</p> <p>- të përcaktojë veprat, revistat dhe botimet paraqitëse të normës;</p> <p>- të tregojë ngjarjet shkencore kryesore që ndihmuan përhapjen dhe zbatimin e standardit gjuhës shqipe.</p>	<p>Publikimet kodifikuese për shqipen standarde</p> <p>Botimi i veprave, revistave e artikujve të shumtë sipas drejtshkrimit dhe që shpjegojnë çështjet lidhur me zbatimin e tij</p> <p>Mbajtja e simpoziumeve, konferencave dhe ngjarje të tjera të kohës për zhvillimin e gjuhës standarde shqipe</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Veprimtaritë mësimore konkretizuese për këto orë përqendrohen te veprat kodifikuese, revistat, artikujt e publikimet e tjera që u botuan menjëherë pas Kongresit të Drejtshkrimit.</p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit jo vetëm që njihen e përballen me publikime të ndryshme, por organ izohen edhe debate konkrete.</p> <p>Bëhen ushtrime për të ilustruar qëndrimet, pikëpamjet dhe shkallën e zotërimit të shqipes standarde, duke përdorur forma të ndryshme diskutimesh, bisedash e debatesh në frymën e zbatimit të shqipes standarde dhe të problemeve e vështirësive që hasin nxënësit në jetën e përditshme.</p>	<p>1.2.1: të trajtojë e të ilustrojë rrugën e kristalizimit të normës letrare deri në vitet '90;</p> <p>1.2.2: të përmendë e të japë të dhëna për veprat e botuara kodifikuese kryesore pas drejtshkrimit të shqipes standarde;</p> <p>1.2.3: të thotë mendimin e vet kritik lidhur me veprimtaritë dhe ngjarjet lidhur me shqipen standarde të kohës së sotme;</p> <p>1.2.4: të përdorë drejt shqipen standarde në të gjitha përdorimet e saj kur flet e kur shkruan.</p>

			Metodat: metoda diakronike, metoda audio-vizuale, metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e analizës; metoda e krahasimit.	
2	Stilistikë gjuhësore			
2.1.	Nxënësi do të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë si funksionon gjuha shqipe si mjet komunikimi; - të përcaktojë stilin funksional dhe veçoritë kryesore të tij; - të dallojë mjetet me vlerë stilistike dhe t'i përmendë stilet funksionale të gjuhës shqipe; - të dallojë veçoritë e çdonjërit stil funksional të gjuhës shqipe. 	Stilistika gjuhësore <p>Gjuha si tërësi varietetesh të përdorimit të saj</p> <p>Stilet funksionale të gjuhës shqipe</p> <p>Konceptet: stilistikë gjuhësore, varietet gjuhësor; stil funksional, stili: i letërsisë artistike, politiko-shoqëror, tekniko-shkencor, administrativo-juridik, i veprimtarisë fetare</p>	Veprimtaritë <p>Nxitet një bisedë në klasë, ku duhet të marrë pjesë secili nxënës, shpjegohen veçoritë dhe u kumtohen njohuritë, jepen qëndrime kritike individuale dhe të grupit, nxirren përfundime për përdorimet e ndryshme të gjuhës si nevoja për komunikim në veprimtari të ndryshme individuale e shoqërore.</p> <p>Nëpërmjet punës në grup dhe nga dy veta, nxënësit simulojnë situata të ndryshme të komunikimit ligjërimitor (ndeshje futbollit, vizitë te mjeku etj.) për të vënë në dukje varietetet dhe mjetet e ndryshme gjuhësore në përshtatje me natyrën e veprimtarisë përkatëse.</p> <p>Gjatë punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njohin, klasifikojnë, formulojnë, grupojnë e krahasojnë veçoritë dhe sjellin</p>	Nxënësi mund: <p>2.1.1: të shpjegojë se gjuha shqipe funksionon si një tërësi varietetesh a nënkodesh gjuhësore;</p> <p>2.1.2: të përkufizojë stilin funksional dhe veçoritë e tij;</p> <p>2.1.3: të nxjerrë në pah mjetet me vlerë stilistike dhe të sqarojë çfarë e karakterizon normën stilistike;</p> <p>2.1.4: t'i numërojë stilet funksionale të gjuhës shqipe;</p> <p>2.1.5: t'i përcaktojë veçoritë e përgjithshme të secilit prej stileve funksionale të gjuhës shqipe.</p>

			<p>shembuj për llojet e ndryshme të stileve funksionale të gjuhës shqipe.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit, metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës, metoda e hulumtimit</p>	
2.2	<p>- të tregojë si realizohet gjuha shqipe e folur;</p> <p>- të përcaktojë stilin e ligjërimit dhe veçoritë kryesore të tij;</p> <p>- të dallojë veçoritë e ligjërimeve të gjuhës shqipe;</p> <p>- të përcaktojë regjistrat e gjuhës shqipe dhe veçoritë e tyre.</p>	<p>Fonetika normative</p> <p>Norma drejtshqiptimore e shqipes standarde</p> <p>Ligjërimet – stilet e gjuhës dhe regjistrat e gjuhës</p> <p>Konceptet: fonetikë normative; normë drejtshqiptimore; stil ligjërimit; ligjërimit: i thjeshtë, bisedor, libror; regjistër i gjuhës, regjistri: i thjeshtë (familjar), i gjuhës së zakonshme, i gjuhës librore (i ngritur)</p>	<p>Veprimtaritë</p> <p>Nëpërmjet punës në grup dhe nga dy veta, duke iu përmbajtur rregullave të mirësjelljes, nxënësit duhet të nxitin / të fillojnë ose të marrin pjesë në aktet e komunikimit për tema që lidhen me shprehitë, nevojat dhe interesat e tyre të përditshme si dhe rreth situatave të përfytyruara të komunikimit nga profesioni i tyre në të ardhmen.</p> <p>Gjatë punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njohin, formulojnë, grupojnë e krahasojnë veçoritë dhe sjellin shembuj për llojet e ndryshme të ligjërimeve a stileve të gjuhës së folur shqipe.</p> <p>Veprimtaritë mësimore konkretizuese gjatë këtyre orëve përqendrohen te fonetika normative dhe realizohen kryesisht nëpërmjet të folurit, duke i dhënë vendin qendror drejtshqiptimit, në krahasim me</p>	<p>2.2.1: të tregojë se ç'është norma drejtshqiptimore;</p> <p>2.2.2: të përcaktojë ligjërimitin – stilin e gjuhës dhe veçoritë e tij;</p> <p>2.2.3: t'i përmendë të gjitha ligjërimet e gjuhës shqipe dhe t'i tregojë veçoritë kryesore të tyre;</p> <p>2.2.4: t'i shpjegojë regjistrat e gjuhës shqipe dhe veçoritë e tyre.</p>

			<p>format dialektore dhe jonormative të gjuhës. Zakonisht mund të përdoren edhe mjete auditive të konkretizimit me qëllim ilustrimi të llojeve përkatëse të ligjërimeve dhe të regjistrave të gjuhës shqipe.</p> <p>Mësimdhënësi i ndjek me vëmendje veprimtaritë e nxënësve dhe ndërhyt sa herë që ka nevojë. Shqiptimi normativ dhe korrekt i mësimdhënësit shërben si shembull dhe si mjet i pakontestueshëm konkretizues gjatë këtyre orëve.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit, metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës, metoda e ilustrimit</p>	
3	Onomastikë			
3.1.	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i dallojë llojet e ndryshme të emrave në tekste dhe në materialin tjetër konkretizues vizual (fotografi tabelash të komunikacionit, harta gjeografike, lista të ndryshme me emra vetjakë, mbiemra dhe llagape); - t'i shkruajë emrat duke iu 	<p>Onomastika Degët e onomastikës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - toponomastika - antroponomastika 	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Shqyrtimi dhe shfrytëzimi i fjalorëve onomastikë.</p> <p>Ushtrime për përpilimin e llojeve të ndryshme të fjalorthëve onomastikë.</p> <p>Ushtrime për formimin e mbiemrave prej emrash të llojeve të ndryshme.</p> <p>Ushtrime me plotësim teksti me lloje të ndryshme emrash dhe me mbiemra të dalë</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>3.1.1: t'i përkufizojë konceptet <i>onomastikë, toponomastikë, antroponomastikë, hidronomastikë, oronomastikë, ojkonomastikë</i></p> <p>3.1.2: të japë shembuj për secilin grup emrash;</p> <p>3.1.3 t'i dallojë llojet e ndryshme</p>

	përmbajtur normës drejtshkrimore të shqipes standarde sa i përket përdorimit të shkronjës së madhe.	Konceptet: onomastikë, toponomastikë, antroponomastikë, hidronomastikë oronomastikë ojkonomastikë stratigrafi toponomosatike, antroponim, emër vetjakë mbiemër, llagap, Fjalor i emrave vetjakë, Fjalor toponimesh, Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve etj.	prej emrash me qëllim të ndërlidhjes së përmbajtjeve mësimore nga drejtshkrimi, përkatësisht me përmbajtjet për shkrimin e shkronjës së madhe dhe të vogël. Biseda për tema të ndryshme që lidhen me emrat vetjakë, me mbiemrat dhe llagapet, ndërsa te kjo pjesë duhet të gjejnë shprehje qëllimet edukative të mësimdhënies nëpërmjet theksimit të faktit se çdokush duhet të jetë krenar për emrin që ka, si dhe për atë se etiketimi i tjetrit me emër fyes e me llagap paraqet akt joqytetëruës, i cili bën ndesh me shprehitë dhe zhvillimin e jetës bashkëkohore dhe me botën bashkëkohore. Metodat: metoda e komunikimit – monolog/dialog; metoda e ndërveprimit, metoda e punës me tekst, metoda e demonstrimit, metoda e përshkrimit, metoda demonstruese	të emrave në tekste dhe në materiale konkretizuese vizuale; 3.1.4: t'i shkruajë emrat sipas normës drejtshkrimore të shqipes standarde.
4	Sintaksa e fjalisë			
4.1	Nxënësi do të jetë i aftë: - të përcaktojë ç'është periudha dhe të tregojë dallimin e saj nga fjalia; - të tregojë mjetet gjuhësore për të	Periudha (fjalia e përbërë) Mjetet gjuhësore për ndërtimin e periudhës Periudha me bashkërenditje dhe llojet e saj	Veprimtaritë: Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë ç'është periudha dhe të	Nxënësi mund: 4.1.1: të tregojë ç'është periudha dhe të përmendë veçoritë kryesore që e dallojnë atë nga fjalia;

	<p>ndërtuar periudhën;</p> <p>- të bëjë dallimin midis periudhës me bashkërenditje dhe periudhës me nënrenditje;</p> <p>- të përcaktojë llojet e periudhave me pjesë të bashkërenditura dhe të tregojë veçoritë e secilës prej tyre.</p>	<p>Konceptet: njësi kallëzuesore; bashkërenditje: këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse dhe shkakore-motivuese.</p>	<p>bëjnë dallimin e saj nga fjalia</p> <p>Veprimtaritë për të ilustruar mjetet për ndërtimin e periudhave bëhen me përgatitje paraprake duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Jepen shembuj me dy fjali që nxënësit prej tyre të ndërtojnë periudhe me bashkërenditje; kërkohet prej nxënësve të plotësojnë vendet e zbrazëta me lidhëzat përkatëse për llojet e ndryshme të periudhave me bashkërenditje; po kështu ata nxiten të bëjnë edhe zëvendësimin e lidhëzave për të përfutur marrëdhënie të ndryshme të bashkërenditjes së pjesëve përbërëse të periudhës.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit/ metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	<p>4.1.2: të përcaktojë mjetet gjuhësore për ndërtimin e periudhës;</p> <p>4.1.3: të bëjë dallimin midis periudhës me bashkërenditje dhe periudhës me nënrenditje;</p> <p>4.1.4: të identifikojë llojet e periudhave me bashkërenditje dhe të sqarojë veçoritë e tyre.</p>
--	--	---	---	--

<p>4.2</p>	<p>- të përcaktojë periudhën me nënrenditje dhe të tregojë mjetet për shprehjen e nënrenditjes;</p> <p>- të dallojë pjesën kryesore nga pjesa e varur dhe të tregojë sa lloje pjesësh të nënrenditura ka;</p> <p>- të identifikojë pjesën e nënrenditur kryefjalore dhe të tregojë llojet dhe veçoritë e tyre;</p> <p>- të vërejë pjesën e nënrenditur kallëzuesore dhe t'i përmendë veçoritë e saj.</p>	<p>Periudha me nënrenditje</p> <p>Periudha me nënrenditje, veçoritë dhe mjetet për shprehjen e nënrenditjes</p> <p>Periudha me pjesë të nënrenditur kryefjalore</p> <p>Periudha me pjesë të nënrenditur kallëzuesore</p> <p>Konceptet: pjesë kryesore; pjesë e varur (e nënrenditur); pjesë e nënrenditur: kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, përcaktore dhe rrethanore; fjali kryefjalore: lidhëzore, urdhërore</p>	<p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë periudhën me pjesë të nënrenditur, duke vënë në pah edhe mjetet për shprehjen e nënrenditjes.</p> <p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet shembujsh të përcaktuar ilustrohen llojet e ndryshme të periudhës me nënrenditje.</p> <p>Bëhet paraqitja skematike e periudhës me nënrenditje kryefjalore dhe e periudhës me nënrenditje kallëzuesore për të nxjerrë në pah veçoritë e tyre ndërtimore dhe funksionale.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit/ metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	<p>4.2.1: të identifikojë periudhën me nënrenditje dhe të shpjegojë veçoritë e saj dalluese;</p> <p>4.2.2: të përcaktojë pjesën kryesore dhe pjesën e varur dhe të përmendë llojet e periudhave me pjesë të nënrenditur;</p> <p>4.2.3: të shpjegojë veçoritë e periudhës me pjesë të nënrenditur kryefjalore, llojet e saj dhe t'i ilustrojë me shembuj nga jeta e përditshme;</p> <p>4.2.4: të përcaktojë periudhën me pjesë të nënrenditur kallëzuesore dhe t'i nxjerrë në pah veçoritë e saj.</p>
------------	--	--	--	--

<p>4.3</p>	<p>- të përcaktojë funksionin që kryen pjesa e nënrenditur kundrinore;</p> <p>- të tregojë si ndahen fjalitë kundrinore dhe të përmendë veçoritë kryesore të tyre;</p> <p>- të dallojë funksionin e pjesës së nënrenditur përcaktore dhe të tregojë llojet e tyre;</p> <p>- të përmendë veçoritë dalluese të fjalive përcaktore lidhore dhe të fjalive përcaktore lidhëzore.</p>	<p>Periudha me pjesë të nënrenditur kundrinore</p> <p>Periudha me pjesë të nënrenditur përcaktore</p> <p>Konceptet: fjali kundrinore: jokorrelative dhe korrelative; fjali përcaktore: lidhore dhe lidhëzore</p>	<p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit</p> <p>Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme për gjymtyrët e dyta të fjalisë me theks të veçantë të kundrinori dhe përcaktori</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë funksionin e pjesës së nënrenditur kundrinore dhe përcaktore në bashkëlidhje me kundrinorin e përcaktorin të fjalive dykryegjymtyrëshe e zgjeruar.</p> <p>Me anë ushtrimesh të ndryshme vihen në dukje llojet e ndryshme të pjesës së nënrenditur kundrinore e përcaktore dhe veçoritë e tyre funksionale e ndërtimore.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit/ metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	<p>4.3.1: të përcaktojë pjesën e nënrenditur kundrinore dhe të shpjegojë funksionin e saj;</p> <p>4.3.2: të shpjegojë ndarjen e fjalive kundrinore dhe të tregojë me shembuj veçoritë dhe mjetet e bashkimit të tyre me pjesën kryesore</p> <p>4.3.3: të përcaktojë pjesën e nënrenditur përcaktore dhe të</p> <p>4.3.4: të japë shpjegime për llojet e fjalive përcaktore dhe t'i ilustrojë me shembuj veçoritë dhe mjetet e bashkimit të tyre me pjesën drejtuese</p>
------------	--	---	--	---

<p>4.4</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të tregojë si ndahen fjalitë pjesa e nënrenditur rrethanore; - të dallojë funksionin e pjesës së rrethanore dhe të përmendë veçoritë kryesore të tyre; - të dallojë funksionin e pjesës së nënrenditur vendore e kohore dhe të tregojë llojet e veçoritë e tyre; - jokorrelative dhe korrelative; fjalive mënyrore, qëllimore e shkakore dhe të tregojë veçoritë e tyre kryesore; - të identifikojë funksionin e pjesës së nënrenditur rrjedhimore e lejore dhe të përmendë veçoritë e tyre kryesore; - të përcaktojë kuptimin dhe funksionin e pjesës së nënrenditur kushtore dhe krahasore dhe të tregojë mjetet e bashkimit të tyre me fjalinë kryesore. 	<p>Periudha me pjesë të nënrenditur rrethanore</p> <p>Llojet e periudhave me pjesë të nënrenditur rrethanore</p> <p>Konceptet: periudhë me pjesë të nënrenditur: vendore, kohore, mënyrore, qëllimore, shkakore, rrjedhimore, kushtore, lejore, krahasore</p>	<p>Veprimtaritë: Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë funksionin e pjesës së nënrenditur rrethanore ndaj pjesës kryesore të saj.</p> <p>Veprimtaritë për të ilustruar mjetet për ndërtimin e periudhave me nënrenditje rrethanore bëhen me përgatitje paraprake duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Jepen shembuj periudhash me pjesë të nënrenditur rrethanore për të vënë në dukje rrethanat e ndryshme (të kohës, vendit, shkakut, qëllimit etj.) që shprehin ato dhe mjetet gjuhësore që shërbejnë për bashkimin e tyre me pjesën kryesore. Mund të praktikohet edhe plotësimi i vendeve të zbrazëta me lidhëzat përkatëse për llojet e ndryshme të periudhave me nënrenditje rrethanore; po kështu ata mund të nxiten të bëjnë dhe zëvendësimin e lidhëzave e fjalëve lidhëse për të përfutur marrëdhënie të ndryshme rrethanore midis pjesës kryesore dhe pjesës së nënrenditur rrethanore.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit/ metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezë</p>	<p>4.4.1: të përcaktojë pjesën e nënrenditur rrethanore dhe të sqarojë veçoritë e tyre në përjasje me funksionet rrethanore që kryen ajo ndaj pjesës kryesore;</p> <p>4.4.2: të identifikojë pjesën e nënrenditur vendore e kohore dhe të shpjegojë veçoritë e tyre;</p> <p>4.4.3: të tregojë veçoritë dalluese të pjesës së nënrenditur mënyrore, qëllimore e shkakore;</p> <p>4.4.4: të përcaktojë funksionin e pjesës së nënrenditur rrjedhimore e lejore;</p> <p>4.4.5: të identifikojë pjesën e nënrenditur kushtore dhe krahasore dhe të tregojë me shembuj funksionet e tyre rrethanore.</p>
------------	--	--	---	---

4.5	<p>- të përcaktojë ç'është ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë, si dhe pjesët përbërëse të tyre;</p> <p>- të tregojë marrëdhëniet midis pjesës lajmuese dhe pjesës përmendëse të ligjërata e drejtë;</p> <p>- të përcaktojë ligjëratën e zhdrejtë dhe ligjëratën e drejtë të lirë dhe t'i përmendë ndryshimet kryesore që ndodhin gjatë kthimit të ligjëratës së drejtë në ligjëratën e zhdrejtë, përkatësisht në ligjëratën e zhdrejtë të lirë;</p> <p>- të zbatojë përdorimin e shenjave përkatëse të pikësimit kur shprehet në ligjëratën e drejtë ose në ligjëratën e zhdrejtë.</p>	<p>Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë</p> <p>Ligjërata e drejtë</p> <p>Ligjërata e zhdrejtë</p> <p>Ligjërata e zhdrejtë e lirë</p> <p>Konceptet: ligjëratë: e drejtë, e zhdrejtë, e zhdrejtë e lirë; pjesë lajmuese; pjesë përmendëse.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë ç'është ligjërata e drejtë, ligjërata e zhdrejtë dhe ligjërata e zhdrejtë e lirë si dhe pjesët e saj përbërëse.</p> <p>Duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm, me profesionin e ardhshëm etj. jepen shembuj me forma të ndryshme riprodhimi të fjalëve të tyre a të dikujt tjetër të thëna më parë dhe kërkohet prej nxënësve të identifikojnë e të dallojnë qartë pjesën lajmuese nga pjesa përmendëse; po kështu ata nxiten të bëjnë edhe kthimin e ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe në ligjëratë të zhdrejtë të lirë si dhe anasjellas, duke vënë në pah ndryshimet që ndodhin e duke pasur vëmendjen gjithmonë të përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit/ metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës</p>	<p>5.1.1: të tregojë ç'është ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë;</p> <p>5.1.2: të përcaktojë pjesën lajmuese dhe pjesën përmendëse të format e ligjëratës;</p> <p>5.1.3: të bëjë kthimin e ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë e në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjellas;</p> <p>5.1.4: t'i përdorë si duhet shenjat e pikësimit gjatë thurjes së ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë.</p>
-----	---	---	---	--

Emërtimi i njësive modulare Letërsi				
Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë nocionin “modern” nga nocioni “modernia”; -të dallojë drejtimitet e ndryshme që i përfshin në vete modernia; -të dijë, simbolizmin, ekspresionizmin, dadaizmin. . , -të dallojë veprat e modernies prej veprave të romantizmit apo realizmit; -ta kuptojë rolin që luan intuita në letërsinë e kësaj periudhe; -të numërojë dhe emërtojë përfaqësuesit kryesor të modernies, si: G. Apolinerin, P. Verlenin, P. Valery-në, A. Rembonë, T. Eliotin, Xh. Xhojsin, M. Prustin, F. Kafkën, etj. 	<p>Letërsia moderne botërore</p> <p>Konceptet: modern, modernia, parnasizmi, simbolizmi, impresionizmi, ekspresionizmi, dadaizmi, surrelizmi. . .</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -jepen shpjegime për dallimin mes nocionit “modern” (të qenit modern, bashkëkohor) dhe “modernia” ; -pyeten nxënësit a kanë lexuar veprat e ndonjë përfaqësuesi të madh të modernies dhe a janë në gjendje t`i kuptojnë risitë që sjellin drejtimitet e ndryshme të modernies; -jepet shpjegimi se krijuesit e kësaj letërsie nuk imitojnë natyrën, por mundohen të krijojnë forma të reja, të panjohura deri atëherë dhe të befasojnë. Modernia i kushton kujdes të veçantë intuitës së njeriut; - nga drejtimitet e modernies më tepër fokusohemi në simbolizmin dhe përfaqësuesit kryesor të tij, si dhe në raportin që vendos simbolizmi me artet tjera, sidomos me muzikën. <p>Metodat: metoda e krahasimit; metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit.</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. të bëjë dallim mes nocionit “modern’ dhe “modernia”; 1.2. të identifikojë drejttime të ndryshme letrare brenda modernies; 1.3. ta kuptojë lidhjet e letërsisë së simbolizmit me muzikën dhe asaj të parnasizmit me artin figurativ; 1.4. t`i emërtojë përfaqësuesit kryesor të modernies dhe kryeveprat e tyre.

2	<p>-të dallojë veçoritë kryesore të vep- rës së Kafkës; -të shpjegojë jetën dhe rrethanat jetësore të Kafkës; -t`i numërojë fazat e krijimtarisë letrare të Kafkës dhe veprat krye- sore të secilës fazë; -të dallojë risitë që solli arti i Kafkës, nëpërmjet të analizës bërë veprës më "pikante" të tij "Metamorfoza"; - të dallojë risitë që solli arti i Kafkës, nëpërmjet të analizës bërë romanit "Procesi"; -të identifikojë elementin psikologjik të romaneve të Kafkës.</p>	<p>Franc Kafka- jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: risitë që solli arti i Kafkës, ele- menti i absurdit dhe ai piskologjik në veprat e Kafkës, dija dhe nëndija e personazheve të Kafkës .</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-duke përsëritur karakteristikat e letërsisë moderne botërore dhe përfaqësuesve më të njohur të saj, ndalemi në informacionet kryesore mbi jetën dhe veprën e Kafkës; -pyeten nxënësit se cilat vepra të Kafkës i kanë të njo- hura dhe çfarë risish sjell arti i tij; -në formë të bashkëbisedimit jepen të dhëna për fazat e krijimtarisë letrare të Kafkës dhe për veprat më të njohura të secilës fazë; -lexohet fragmenti i dhënë në libër (nga romani "Procesi") dhe pyeten nxënësit se kush e ka lexuar vep- rën dhe sa janë në gjendje ta analizojnë; -bashkë me nxënësit bëhet analiza e romanit dhe analiza e personazhit kryesor, Jozef K.; -duke analizuar personazhin kryesor të veprës, mundohemi t`i shpjegojmë elementet e moskuptimit dhe kontradiktës; - sqarohen dhe arsyetohen tiparet fizike të personazheve, mënyrën se si mendojnë dhe mënyrën si veprojnë; - diskutohet rreth pjesëve të romanit "Procesi"; Gjyq pa gjyqtar, Faj pa fajtor, Burg pa të burgosur dhe Drejtësi pa të drejtë.</p> <p>Metodat: metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e</p>	<p>2.1. të identifikojë veprën e Kafkës; 2.2. të dallojë veçoritë e artit të Kafkës; 2.3. ta analizojë veprën "Procesi"; 2.4. ta analizojë Jozef K. si personazh; 2.5. ta përcaktojë vendin e Kafkës në letërsinë botë- rore.</p>
---	---	--	---	---

			demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit.	
3	<p>- të identifikojë veçoritë e artit të Kamysë;</p> <p>-të njohë rrethanat jetësore të Kamysë;</p> <p>-të kuptojë rëndësinë e romanit të Kamysë;</p> <p>-nëpërmjet të subjektit të romanit "I huaji ", të identifikojë stilin neutral, transparent, akohor të Kamysë;</p> <p>-të shpjegojë ngjarjet kryesore që trajtohen në roman;</p> <p>-të analizojë personazhin kryesorë, figurën komplekse të Mersoit;</p> <p>-të dallojë veçoritë kryesore të artit të Kamysë.</p>	<p>Albert Kamy - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: dukuria origjinale dhe vlera e spikatur e letërsisë moderne, ndërtimi i personazheve, rrëfimi dhe rrëfyesi, tragjedia absurde.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-në formë të përsëritjes, nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me karakteristikat dhe veçantitë e letërsisë moderne franceze dhe përfaqësuesit kryesor të saj;</p> <p>-ndalemi në jetën dhe veprën e Kamysë, duke dhënë informacion edhe për epokën, në të cilën jetoi dhe veproi dhe për prejardhjen e tij;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me veprat e Kamysë për të cilat kanë dëgjuar, i kanë lexuar ose i kanë parë si realizime filmike;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, analizohet vepra "I huaji" dhe jepen gjykime për temën dhe idenë e veprës;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre për romanin dhe personazhin kryesorë të romanit;</p> <p>-pasi të analizohet vepra dhe të lexohet e komentohet fragmenti i dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit që të prononcohen në lidhje me personazhin kryesorë të romanit dhe vlerën e romanit;</p> <p>-nxiten nxënësit që të japin gjykime në lidhje me vendin që zë A. Kamy në letërsinë botërore.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>3.1. ta kuptojë rolin dhe vendin që zë Kamy në letërsinë botërore;</p> <p>3.2. të identifikojë stilin e veprave të Kamysë;</p> <p>3.4. të analizojë romanin e Kamysë dhe të kuptojë vlerën e tij;</p> <p>3.5. t`i analizojë personazhet kryesore të romanit "I huaji".</p>

4	<p>- të identifikojë veçoritë e artit të E. Heminguejt;</p> <p>-të njohë rrethanat jetësore të Heminguejt;</p> <p>-të kuptojë rëndësinë e romaneve më të njohura të Heminguejt;</p> <p>-nëpërmjet të subjektit të romanit “Plaku dhe deti”, të identifikojë stilin autobiografik romanesk të E. Heminguejt;</p> <p>-të shpjegojë ngjarjet kryesore që trajtohen në roman;</p> <p>-të analizojë personazhin kryesorë, figurën e plakut Santiago;</p> <p>-të dallojë veçoritë kryesore të artit të Heminguejt.</p>	<p>Ernest Heminguej- jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: dukuria origjinale dhe vlera e spikatur e letërsisë moderne, ndërtimi i personazheve, rrëfimi, heroit, simbolika.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-në formë të përsëritjes, nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me karakteristikat dhe veçantitë e letërsisë moderne europiane dhe amerikane, meqë E. Heminguej u takon të dy letërsive;</p> <p>-ndalemi në jetën dhe veprën e E.Heminguejt, duke dhënë informacion edhe për epokën, në të cilën jetoi dhe veprimi, prejardhjen e tij;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me veprat e Heminguejt për të cilat kanë dëgjuar, i kanë lexuar ose i kanë parë si realizime filmike;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, analizohet vepra “Plaku dhe deti” dhe jepen gjykime për temën dhe idenë e veprës;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre për romanin dhe personazhin kryesorë të romanit, plakun Santiago;</p> <p>-pasi të analizohet vepra dhe të lexohet e komentohet fragmenti i dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit që të prononcohen në lidhje me personazhin kryesorë të romanit dhe vlerën e romanit;</p> <p>-nxiten nxënësit që të japin gjykime në lidhje me vendin që zë Heminguejt në letërsinë botërore.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>4.1. ta kuptojë rolin dhe vendin që zë Ernest Heminguej në letërsinë botërore;</p> <p>4.2. të identifikojë stilin e veprave të Heminguejt;</p> <p>4.4. të analizojë romanin “ Plaku dhe deti” dhe të kuptojë vlerën e tij;</p> <p>4.5. t`i analizojë personazhet kryesore të romanit.</p>
---	--	---	--	--

5	<p>-të përcaktojë vendin e Markesit në letërsinë botërore;</p> <p>-të njohë Markesin si një nga theme luesit e letërsisë moderne spanjolle;</p> <p>-të njihet me kontributin e Markesit për t`i dhënë një frymëmarrje të re gjinisë së romanit;</p> <p>-të identifikojë veçantitë stilistikore të artit të Markesit;</p> <p>-nëpërmjet të shembullit tëMarkesit, të bëjë dallim mes jetës së autorit dhe veprës së tij;</p> <p>-të analizojë “Njëqind vjet vetmi” dhe të japë vlerësimet e tij për këtë kryevepër të Markesit dhe të letërsisë botërore;</p> <p>-të ndalet në vlerat artistike të romanit.</p>	<p>Gabriel Garsia Markes - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: letërsia spanolle, letërsia amerikano-latine, zhanret letrare, diktatura, dëshpërimi dhe dashuria, realizmi magjik , struktura, temat, idetë.</p>	<p>- Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njihen me jetën dhe veprën e E. A. Po-es dhe me faktin se Markesi ishte autor, arti i të cilit i paraprinte kohës dhe që u quajt “ realizëm magjik”;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxënësit motivohen të mendojnë se vepra e autorit zanafillën e ka te rrëfenjat e gjyshit;</p> <p>- kërkohet analizë edhe e formës edhe e përmbajtjes;</p> <p>- nxënësit njihen me personazhet e çuditshme në situata të pazakonta ;</p> <p>-diskutohen tri temat e veprimtarisë së Markesit, ajo e diktaturës, dëshpërimit dhe dashurisë (DDD);</p> <p>-n njihen me gjenezën e romanit “ Njëqind vjet vetmi”;</p> <p>- diskutohet rreth fisit Buendia dhe banorëve të Makondos, qyteteve dhe qytetërimit të zhdukur.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>5.1. të identifikojë veprën e G.G. Markesit dhe vendin që zë ajo në letërsinë botërore;</p> <p>5.2. t`i numërojë zhanret dhe llojet letrare që i trajtoi Markesi;</p> <p>5.3. të analizojë romanin “Njëqind vjet vetmi”;</p> <p>5.4. të analizojë historinë e ngjarjes dhe gjenezën e saj.</p>
1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>- të njohë historinë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX;</p> <p>- të mësojë zhvillimin e letërsisë shqiptare të ndarë nga kufinj politik;</p> <p>- të dijë rrjedhën e letërsisë</p>	<p>Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore</p> <p>Konceptet: proza, poezia, drama shqiptare, dukuritë historike dhe</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>- jepet panoramë e përgjithshme për rrugën e vështirë dhe mjaft komplekse të letërsisë shqiptare;</p> <p>- informohen nxënësit për dukuritë historike dhe letrare të kësaj periudhe;</p> <p>- pyeten nxënësit a kanë njohuri për ndarjen e kufirit politik dhe ndikimit të kësaj ndarje në zhvillimin letrar;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.1.të bëjë dallim ndërmjet letërsisë bashkëkohore botërore dhe asaj shqiptare;</p> <p>1.2.të identifikojë drejtime të ndryshme letrare brenda letërsisë së kësaj periudhe;</p>

	<p>shqiptare në përgjithësi, si dhe fizionominë, strukturën artistike apo frymëzimin tematik të saj ;</p> <p>-ta kuptojë rolin që luan intuita në letërsinë e kësaj periudhe;</p> <p>-të numërojë dhe emërtojë përfaqësuesit kryesorë të letërsisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit .XX;</p> <p>-t`i numërojë dhe shpjegojë gjinitë dhe llojet letrare më të zhvilluara në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-t`i dallojë dhe identifikojë elementet e drejtimeve të ndryshme letrare në letërsinë shqipe të kësaj periudhe.</p>	<p>letrare.</p>	<p>-jepet shpjegimi se krijuesit e kësaj letërsie shquhen për laramaninë stilistike;</p> <p>-informohen dhe diskutohet për zhvillimin e poezisë, prozës dhe dramës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore;</p> <p>-nxiten nxënësit të mendojnë rreth gjinive më të lëvruara letrare dhe veprave më të njohura nga secila gjini;</p> <p>-përmenden përfaqësuesit kryesor të letërsisë shqipe të kësaj periudhe dhe veprat e tyre më të njohura;</p> <p>- pyeten nxënësit a kanë lexuar vepra të përfaqësuesve të kësaj periudhe (J.Xoxa, D. Agolli, P. Marko, I. Kadare etj).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>1.3. të identifikojë historinë shqiptare;</p> <p>1.4. të numërojë dhe emërtojë përfaqësuesit kryesorë të letërsisë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX;</p> <p>1.5. të dallojë poezinë, prozën dhe dramën shqiptare.</p>
2	<p>-të identifikojë veçoritë e artit të Petro Markos;</p> <p>-të njohë rrethanat jetësore të P. Markos dhe kontributin e tij në jetën politike;</p> <p>-të kuptojë rëndësinë e romaneve më të njohura të P. Markos;</p> <p>-nëpërmjet të subjektit të romanit "Hasta la vista" të identifikojë</p>	<p>Petro Marko - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: njeriu dhe krijuesi, besimi në dashuri, humanizmi njerëzor, horizonti poetik, romani, gërshtimi i realitetit</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-në formë të përsëritjes, nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me karakteristikat dhe veçantitë e letërsisë së pas Luftës së Dytë Botërore dhe përfaqësuesit kryesor të saj;</p> <p>-ndalemi në jetën dhe veprën e Petro Markos, duke dhënë informacion edhe për epokën, në të cilën jetoi dhe veproi;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me veprat e Markos për të cilat kanë dëgjuar, i kanë lexuar ose i kanë</p>	<p>2.1. ta kuptojë rolin dhe vendin që zë Marko në letërsinë shqiptare;</p> <p>2.2. të identifikojë stilin e veprave të Markos;</p> <p>2.4. të analizojë romanet kryesore të Markos dhe të kuptojë vlerën e tyre;</p> <p>2.5. t`i analizojë personazhet kryesore të romanit "Hasta la vista".</p>

	<p>elementet realiste të veprës së P. Markos;</p> <p>-të shpjegojë ngjarjet kryesore që trajtohen në romanet kryesore të P. Markos;</p> <p>-të analizojë personazhet kryesore të veprave të Markos;</p> <p>-të dallojë veçoritë kryesore të artit të Markos.</p>	<p>me artistiken, rebelizmi individual, rebelizmi revolucionar.</p>	<p>parë si realizime filmike;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, analizohet vepra "Hasta la vista" dhe jepen gjykime për temën dhe idenë e veprës;</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre për personazhet kryesore të romanit, Anitën dhe Gorin;</p> <p>-pasi të analizohet vepra dhe të lexohet e komentohet fragmenti i dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit që të prononcohen në lidhje me personazhet kryesore të romanit dhe vlerën e romanit;</p> <p>-diskutohet rreth mesazhit të fragmentit në lidhje me dashurinë si ndjenjë universale dhe internacionalizmin njerëzor;</p> <p>-nxiten nxënësit që të japin gjykime në lidhje me vendin që zë Markos në letërsinë shqiptare.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	
3	<p>-ta përshkruajë rrugën jetësore të Jakov Xoxës, atë kulturore dhe letrare;</p> <p>-të memorojë veprat kryesore të Jakov Xoxës;</p> <p>-t'i numërojë preokupimet tematike të romanit të Xoxës;</p> <p>-të dallojë prozatorin me gjerësi epike;</p> <p>-të përcaktojë hapësirën e jetës dhe të</p>	<p>Jakov Xoxa – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet prozatori me gjerësi epike, romani, bota komplekse shqiptare, "</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për rrugën jetësore të Xoxës dhe veprat e tij kryesore;</p> <p>-pyeten nxënësit se cilat janë veprat më të njohura të Xoxës;</p> <p>-më ndihmën e nxënësve, analizohet "Lumi i vdekur";</p> <p>-pasi shpjegohet subjekti i veprës, diskutohet rreth raportit të veprës me historinë shqiptare dhe realitetin;</p>	<p>3. 1.ta përcaktojë vendin e Xoxës në letërsinë tonë kombëtare;</p> <p>3.2. t'i numërojë veprat më të njohura letrare të Xoxës;</p> <p>3.3. ta analizojë "Lumi i vdekur" të Xoxës;</p> <p>3.4. t'i numërojë personazhet kryesore të kryeveprës së Xoxës;</p>

	<p>ekzistencës së mjedisit shqiptar në veprën e Xoxës;</p> <p>- të përcaktojë vendin dhe rëndësinë e Xoxës në letërsinë shqiptare.</p>	<p>Lumi i vdekur”, ”Juga e bardhë”, ” Lulja e kripës”, lufta, dashuria, familja.</p>	<p>-analizohen personazhet kryesore të romanit, si: Pilo Shpiragu, Sulejman Tafilaj,Vita, Adili;</p> <p>- diskutohet rreth preokupimeve tematike të romaneve të Xoxës;</p> <p>-në formë të rezimesë, kërkohet nga nxënësit që t`i shprehin mendimet e tyre rreth vendit të Xoxës në jetën shoqërore, kulturore dhe letrare të kësaj periudhe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	
4	<p>-të kuptojë vendin që zë Dritëro Agolli në letërsinë shqipe;</p> <p>-të fitojë njohuri mbi jetën dhe veprën e D. Agollit;</p> <p>- të identifikojë preokupimet tematike të veprimtarisë së D. Agollit;</p> <p>-ta shpjegojë dhe analizojë ”Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”;</p> <p>-t`i përmend preokupimet tematike të poezive dhe prozës të D. Agollit;</p> <p>- të diskutojë traditën e re të letërsisë shqiptare, që e solli D. Agolli.</p>	<p>Dritëro Agolli - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: gjinitë letrare, llojet letrare, preokupimet tematike, dhimbja njerëzore, ”Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”.</p>	<p>Veprimtaritë</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Dritëro Agollit;</p> <p>-shpjegohet kontributi i Agollit në modelin e ri të vjershërimit;</p> <p>- lexohet fragmenti i dhënë nga ” Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe nxiten nxënësit që të mendojnë rreth temës së romanit;</p> <p>-jepen shpjegime shtesë mbi këtë roman dhe kërkohet nga nxënësit që të analizojnë personazhet Zylo dhe</p> <p>Demoja;</p> <p>- jepen informacione për temat e veprave tjera të Dritëro Agollit;</p> <p>- nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre mbi Agollin si dhe vendit që zë ai në letërsinë shqipe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst.</p>	<p>4.1. të fitojë pasqyrë të përgjithshme mbi vendin e Dritëro Agollit në letërsinë shqipe;</p> <p>4.2. t`i përmend veprat e botuara të Dritëro Agollit;</p> <p>4.3. t`i numërojë preokupimet tematike të romanit të Agollit;</p> <p>4.4. të analizojë ”Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”;</p> <p>4.5. të analizojë personazhet kryesore të kësaj vepre.</p>

5	<p>-t`i identifikojë rrethanat, në të cilat u paraqit dhe u krijua figura e Ismail Kadaresë;</p> <p>-të njohë jetën dhe veprën e Kadaresë;</p> <p>-të numërojë kontributin e Kadaresë në më shumë sfera të dijes, si në: diplomaci, publicistikë, gjuhësi, veprimtari përkthyes, kritikë letrare dhe letërsi, veçmas në fushën e prozës;</p> <p>-të memorojë llojet e prozës që lëvroi Kadareja dhe risitë që solli në fushën e prozës;</p> <p>-të identifikojë elementin modern të prozës së Kadaresë;</p> <p>-të analizojë "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" dhe personazhet kryesore të saj;</p> <p>-të njohë kontributin e Kadaresë për t`i kthyer mitet legjendare në realitet;</p> <p>-t`i kuptojë vlerat dhe porosinë e veprave tjera të rëndësishme të Kadaresë: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"" Kronikë në gur", " Kështjella", "Kush e solli Doruntinën". . .;</p>	<p>Ismail Kadare - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: publicistika, gjuhësia, diplomacia, poezia, proza poetike, proza portret, tregimi, romani, kritika letrare, përkthimi letrar, polemikat, qëndrimi kritik ndaj veseve shqiptare, ambasador i kulturës dhe traditave shqiptare.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë, duke u ndalë në veprimtarinë e tij në kryqendrat botërore, si në: Paris, Bruksel, Londër e Uashington;</p> <p>-njohtohen nxënësit me kulturën enciklopedike të Kadaresë;</p> <p>-jepen informacione për rolin që luan Kadareja në letërsinë shqiptare;</p> <p>-bashkë me nxënësit analizohet "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe personazhet kryesore të veprës;</p> <p>-komentohet lloji letrar i veprës dhe mendimet e kritikës rreth kësaj çështje;</p> <p>-ndalemi në gjuhën e kësaj vepre të Kadaresë dhe jepen informacione për kontributin e Kadaresë në fushën e gjuhës në përgjithësi dhe të gjuhës së veprës letrare, në veçanti;</p> <p>-jepet informacion për veprat tjera të Kadaresë, për Kadarenë si poet, për kontributin e tij në lëvrimin e llojeve të caktuara të prozës, si: prozës poetike, prozës portret, skicës, eseut, tregimit dhe nëse koha na lejon, secili lloj prozaik shpjegohet me një shembull konkret dhe detajor;</p>	<p>5.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin e Kadaresë në kulturën dhe letërsinë shqipe;</p> <p>5.2.të numërojë dhe memorojë kontributin e Kadaresë në më tepër fusha të dijes, si në publicistikë, gjuhësi, veprimtari përkthyes dhe mbi të gjitha, në letërsi, veçmas në prozë;</p> <p>5.3.t`i numërojë dhe emërtojë llojet e prozës që i lëvroi Kadareja dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin e prozës shqiptare;</p> <p>5.4.ta analizojë "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur " të Kadaresë dhe personazhet kryesore të saj;</p> <p>5.6.të memorojë titujt e veprave tjera të Kadaresë;</p> <p>5.7.të shkruaj një ese për një veper të Kadaresë , sipas zgjedhjes së tij.</p>
---	--	---	--	---

	<p>-të përcaktojë vendin e Kadaresë në letërsinë shqipe dhe rolin e tij në afirmimin e letërsisë, kulturës, traditës, folkorit dhe qenies shqiptare në qarqet botërore.</p>		<p>-nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një ese për ta lexuar dhe komentuar; -dëgjohen komentet e secilit grup dhe jepen shpjegime shtesë, sipas nevojës; -kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një ese, ku do të analizojnë një vepër të Kadaresë (sipas zgjedhjes së tyre).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	
6	<p>-të përshkruajë vendin e Anton Pashkut në kulturën dhe letërsinë shqipe; -të njohë rrethanat shoqërore shqiptare, kosovare të kohës dhe kontributin e Anton Pashkut në to; -të analizojë veprat e Anton Pashkut , -ta kuptojë simbolikën e veprave të Pashkut; -ta kuptojë kontributin e Pashkut në fushën e prozës; - të njohë romancierin modern shqiptar.</p>	<p>Anton Pashku – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: romancier modern shqiptar, tregimi, rrethi tematik i vetmisë, drama “GOF”, “Sinkopa”, romani “Oh”, tregimi., “Kulla”, “ Klithma”, “ Në stuhi”</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njihen me të dhënat jetësore mbi Anton Pashkun dhe kontributin e tij në më shumë sfera; -bashkë me nxënësit lexohen dhe analizohen tregime të Pashkut; -jepen informacione për Pashkun si romancier duke u ndalë në romanin “Oh”; - analizohet koha dhe rrëfimi, lidhja e nyjeve kohore, zhytja e rrëfimitarit drejt retrospektives së njëfishtë dhe dyfishtë në rrëfimin romanesk, që sajohet përmes teknikës moderne; -jepen informacione për Pashkun si dramaturg , duke u ndalë në dramën e tij.</p> <p>Metodat:metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>6.1.të shpjegojë vendin e Pashkut në kulturën shqiptare; 6.2.t`i memorojë tregimet më të njohura të Pashkut`; 6.3.t`i numërojë dhe shpjegojë dramën e Pashkut; 6.4t`i numërojë dhe emërtojë romanet e Pashkut.</p>

7	<p>-të përshkruajë vendin e Murat Isakut në letërsinë shqipe;</p> <p>- të njihen me jetën dhe veprën letrare të Murat Isakut;</p> <p>- të dinë mbi rëndësinë dhe rolin që luajti vepra e tij në zhvillimin e letërsisë dhe shijes estetike të një pjesë e shqiptarëve;</p> <p>- të analizojnë romanin <i>“Plagët”</i>.</p>	<p>Murat Isaku –jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: roman, poezi, kujtime nga e kaluara, robëri shekullore.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e Murat Isakut;</p> <p>-lexohen poezi të motiveve të ndryshme (motivit patriotik, erotik dhe shoqëror) dhe nxiten nxënësit të mendojnë rreth preokupimeve kryesore tematike të poezisë Murat Isakut;</p> <p>-lexohen fragmenti nga romani <i>“Plagët”</i>, i cili analizohet dhe kërkohet nga nxënësit që të mendojnë se cilat kategori të njerëzve i demaskon autori në këtë vepër;</p> <p>-lufta për liri dhe rezistenca ndaj robërisë shekullore janë temat qendrore të veprimtarisë letrare të Murat Isakut.</p> <p>- nxiten nxënësit të mendojnë rreth karakteristikave gjuhësore të veprës së Murat Isakut dhe leksikut të veprës së tij.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>7.1.ta identifikojë veprën e Murat Isakut;</p> <p>7.2.të njohë kontributin e Murat Isakut në letërsinë shqipe dhe ndikimin që pati poezia e tij te poetët më të rinj;</p> <p>7.3.ta njohë raportin e poezisë së Murat Isakut me folklorin shqiptar;</p> <p>7.4.të njohë veçantitë gjuhësore të veprës së Murat Isakut;</p> <p>7.5.t`i numërojë e memorojë tituj e poezive më të njohura patriotike, erotike e shoqërore të Murat Isakut;</p> <p>7.6. ta shpjegojë e analizojë romanin <i>“Plagët”</i>.</p>
8	<p>-të njohë vendin e A. Islamit në letërsinë shqipe;</p> <p>-të identifikojë elementet moderne të poezisë të A.Islamit;</p> <p>-të numërojë preokupimet tematike të poezisë së A.Islamit;</p>	<p>Abdylazis Islami – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: poezi moderne, elementet ro</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për jetën dhe veprën e A: Islamit;</p> <p>-lexohen disa poezi dhe shpjegohet përpjekja e Islamit që të sjell tone të reja në poezinë shqipe;</p> <p>-jepen shpjegime për përkufizimin që jep A.Islami për da-</p>	<p>8.1. ta përcaktojë vendin që zëA. Islami në letërsinë shqipe;</p> <p>8.2. të përmend elementet moderne të poezisë së A.Islamit;</p> <p>8.3. t`i numërojë dhe emërtojë motivet dhe temat kryesore të</p>

	<p>- të njihen me jetën dhe veprën letrare të autorit;</p> <p>- të analizojë poezi të caktuara dhe romanin <i>"Fatiana"</i>...;</p>	<p>mantike,qëndrimi ndaj fjalës dhe muzikalitetit, poezia erotike, poezia deskriptive, poezia patriotike, poezia filozofike, tregime , romane, drama.</p>	<p>shurinë dhe për temat që i gjejmë brenda poezisë erotike;</p> <p>-nxiten nxënësit që të gjejnë elementet përshkruese, patriotike dhe filozofike;</p> <p>-njihen me tregime , romane, drama të Islamit;</p> <p>-njihen nxënësit me kontributin e Islamit në kritikën letrare dhe eseistikën, në mbledhjen dhe studimin e folklorit shqiptar të Sharrit; kontributin në fushën e perktitimeve letrare nga maqedonishtja dhe kroatishtja</p> <p>-njohtonen nxënësit me faktin se veprat e A. Islamit janë perkthyer në: turqisht, maqedonisht, arabisht, italisht, kroatisht, sllovenisht, gjermanisht, anglisht, suedisht, ruisht, rumunisht, hungarisht, vietnamisht, disa me panorama e disa me antologji;</p> <p>- nxënësit lexojnë fragmentin e dhënë nga romani <i>"Fatiana"</i> dhe e analizojnë.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e komunikimit ; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>poezisë së A.Islamit;</p> <p>8.4. ta analizojë romanin <i>"Fatiana"</i>.</p>
9	<p>-t'i njohë rrethanat e kohës, në të cilën u krijua vepra letrare eAzem Shkrelit;</p> <p>-të identifikojë raportin e veprës së Shkrelit me folklorin shqiptar dhe me filozofinë fetare;</p> <p>-të shpjegojë llojet e prozave që trajtoi Shkreli dhe kontributin e tyre;</p> <p>-të numërojë dhe emërtojë</p>	<p>Azem Shkreli- jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: mjeshtri i vargut dhe fjalës poetike, spektri i zgjeruar tematik, gjuha, poezi e ngarkuar me patosin e</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione për rrugën jetësore dhe për veprimtarinë letrare të Azem Shkrelit;</p> <p>-në pika të shkurta informohen nxënësit me preokupimet tematike të poezisë së Shkrelit;</p> <p>-jepen informacione për llojet e prozave që i trajtoi Shkreli, duke u ndalë veçmas te tregimet dhe preokupimet tematike të tyre;</p>	<p>9.1. ta vlerësojë kontributin e Shkrelit në zhvillimin e letërsisë shqipe, veçmas të prozës;</p> <p>9.2. të shpjegojë preokupimet tematike të prozës së Shkrelit ;</p> <p>9.3. të identifikojë veçoritë gjuhësore e stilistike të prozës së Shkrelit;</p>

	<p>preokupimet tematike të tregimeve të Shkrelit;</p> <p>-të analizojë "Sytë e Evës";</p> <p>-të njohë përpjekjen e Shkrelit për të trajtuar prozën e gjatë (novelën dhe romanin);</p> <p>-të dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të prozës së Shkrelit dhe vendin e saj në letërsinë shqipe.</p>	<p>euforisë kolektive, lirikat e dashurisë, atdhetare, refleksive.</p>	<p>-lexohen fragmente të dhëna nga "Sytë e Evës";</p> <p>-nxiten nxënësit të mendojnë rreth mesazhit që jep autori në këtë vepër;</p> <p>-shpjegohet subjekti dhe nxiten nxënësit të bëjnë analizë psikologjike;</p> <p>- nxiten nxënësit që, duke u mbështetur në fragmentin e dhënë, të diskutojnë rreth gjuhës dhe stilit të prozës së Shkrelit;</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për Shkrelit si poet dhe si autor të prozës së gjatë (novelës dhe romanit).</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e demonstrimit, metoda e komunikimit, metoda analitike, metoda e krahasimit.</p>	<p>9.4. të shpjegojë "Sytë e Evës";</p> <p>9.5. të identifikojë raportin e prozës së Shkrelit me folklorin shqiptar.</p>
--	--	--	--	--

10	<p>-të njohë rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Nazmi Rrahmanit;</p> <p>-të dallojë elementet popullore të veprës së Rrahmanit;</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme mbi preokupimet tematike të prozës së Rrahmanit;</p> <p>-të analizojë romanin “Malësorja”;</p> <p>-të numërojë personazhet më të njohura të veprës së Rrahmanit, si malësorin, malësoren, nënën që mallkon fëmijën e saj, etj.;</p> <p>-të kuptojë risitë që sjell vepra e Rrahmanit në përmbajtje dhe formë.</p>	<p>Nazmi Rrahmani -jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: proza me motiv nga jeta e fshatit, romani, tragjedia, zakonet, traditat.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-pyeten nxënësit se cilat vepra të Migjenit i njohin;</p> <p>-jepin informacione mbi jetën dhe veprën e Rrahmanit dhe vendin që zë Nazmi Rrahmani në letërsinë shqipe;</p> <p>-ndalemi te romanin “ Malësorja”;</p> <p>-lexohet fragmenti dhe kërkohet nga nxënësit që të shprehin mendimet e veta në lidhje me këtë vepër;</p> <p>- analizphen personazhet kryesore të romanit si: Hajrija, Hasani, Sania;</p> <p>-diskutohet rreth tragjedisë në vepër;</p> <p>-diskutohet rreth jetës së malësisë, jetës së femrës shqiptare të malësisë, traditave dhe zakoneve;</p> <p>-nxiten nxënësit të shprehin opinionet e tyre mbi vendin</p>	<p>10.1. të formojë një opinion të përgjithshëm mbi veprën e Nazmi Rrahmanit dhe vendit që zë ajo në letërsinë shqipe;</p> <p>10.2. të identifikojë qëndrimin kritik të N. Rrahmanit ndaj shoqërisë shqiptare të kohës;</p> <p>10.3. t`i njohë preokupimet tematike të veprës së Rrahmanit;</p> <p>10.4.të vlerësojë risitë që sjell vepra e Rrahmani në përmbajtje;</p> <p>10.5. të analizojë romanin “ Malësorja”;</p>
			<p>e Rrahmanit në letërsinë tonë kombëtare;</p> <p>-analizohet gjuha e Nazmi Rrahmanit.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst, metoda e komunikimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>10.6. të analizojë personazhin kryesor të romanit, Hajrien;</p> <p>10.7. t`i njohë karakteristikat gjuhësore të Rrahmanit.</p>

11	<p>-të njohë rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Ali Podrimjes;</p> <p>-të dallojë veçantitë e veprës së Ali Podrimjes;</p> <p>-të analizojë përmbledhjet poetike të A. Podrimjes: "Lum Lumi", "Hija e tokës", "Torzo", "Pylli" dhe rolin që luan ai në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-të numërojë veprat tjera të Podrimjes dhe të fitojë një pasqyrë mbi vendin e tyre në letërsinë shqipe.</p>	<p>Ali Podrimja – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet:, idealist me dilema ekzistenciale, poet në shkallë kombëtare, elegji, frymëzim tematik politik, e kaluara e Kosovës.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njohtohen me të dhënat jetësore mbi Ali Podrimjen dhe veprimtarinë e tij letrare;</p> <p>-nxiten nxënësit që t`i shprehin mendimet e veta rreth vëllimit "Lum Lumi" dhe rolit që luan ai në letërsinë shqipe të kohës;</p> <p>-analizohet ciklet poetike të Ali Podrimjes;</p> <p>-lexohet "Me jetue" (kushtuar djalit) dhe kërkohet që nxënësit ta analizojnë;</p> <p>-pasi të shpjegohen poezitë, nxiten nxënësit që t`i krahasojnë tematikat e poezive.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>11.1. të fitojë një pasqyrë mbi jetën dhe veprën e Ali Podrimjes;</p> <p>11.2. të analizojë poezitë kryesore të A. Podrimjes;</p> <p>11.3. ta kuptojë rolin që luan poeti në letërsinë shqipe të kohës.</p>
12	<p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e Adem Gajtani;</p> <p>-t`i numërojë preokupimet tematike të poezisë së A.Gajtanit në faza të</p> <p>-ta analizojë përmbledhjen poetike të Adem Gajtani;</p> <p>- t`i analizojë poezitë "Dëshira" dhe</p>	<p>Adem Gajtani – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet:, poezi shqipe në Maqedoni, poezi lirike, motivi social, motivi patriotik.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Adem Gajtani dhe vendin që zë ai në letërsinë shqipe;</p> <p>-nxiten nxënësit ta analizojnë përmbledhjen poetike duke u ndalë në motivet dhe temat e cikleve të caktuara;</p> <p>-lexohen dhe analizohen poezitë më të njohura të Adem</p>	<p>12.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin që luan dhe vendin që zë poezia e Adem Gajtani në letërsinë shqipe;</p> <p>12.2. t`i numërojë dhe emërtojë veprat e Adem Gajtani;</p> <p>12.3. t`i identifikojë motivet dhe temat kryesore të poezisë së</p>

	<p>“Kanga”, “ Drita në zemër”...;</p> <p>-t`i krahasojë poezitë e Adem Gajtanit me ato të Ali Podrimjes;</p> <p>-të njihet me bashkëpunimin e tij me autorë të tjerë;</p> <p>-ta kuptojë vendin e Adem Gajtanit në poezinë shqipe në Maqedoni.</p>		<p>Gajtanit;</p> <p>-analizohen veçmas poezitë: “As dru as zog, - dashuri”, “ Kanga”, “ Ti kangë ti zog i largët”, “Intervistë”...</p> <p>-diskutohet rreth elementit politik dhe social të poezisë së Gajtanit;</p> <p>-nxiten nxënësit të diskutojnë rreth rolit që luan poezia e Adem Gajtanit në zhvillimin e letërsisë shqipe në Maqedoni;</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>A.Gajtanit;</p> <p>12.4. t`i analizojë poezitë më të njohura, sidomos poezitë që janë dhënë në libër;</p> <p>12.5. t`i dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të poezisë së Adem Gajtanit;</p>
Emërtimi i njësive modulare Komunikimi dhe shkrimet funksionale				
Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>-t`i njeh hapat e shkrimit të tregimit, duke filluar nga të kuptuarit e temës e deri te shkrimi i kopjes përfundimtare;</p> <p>-të njihet me strukturën e tregimit dhe mënyrat e shkrimit të saj.</p> <p>- të tregojnë lirshëm e pa probleme në gjuhën letrare shqipe për ngjarje e fenomene të jetës shoqërore, politike e kulturore;</p> <p>- të kultivojnë respektin, tolerancën,</p>	<p>Tregimi</p> <p>Konceptet: të kuptuarit e temës, diskutimi i ideve, hartimi i tezës filletare, përpunimi i listës, organizimi i paragrafeve, hartimi i skicë-ide-së, përgatitja e kopjes së parë, rishikimi dhe redaktimi, korrigjimi,</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>-nxënësit njihen me tregimin dhe strukturën e tij;</p> <p>-jepen informacione për hapat që duhet ndjekur gjatë shkrimit të tregimit ;</p> <p>-jepen informacione për strukturën e tregimit;</p> <p>-shpjegohet roli i skenës dhe personazheve në tregim;</p> <p>-shpjegohet roli i hyrjes, brendisë dhe përfundimit të tregimit;</p> <p>-kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë tregim në temë të caktuar, duke i kushtuar kujdes edhe anës formale të shkrimit;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.1.të dallojë fazat e shkrimit të tregimit;</p> <p>1.2. ta kuptojë rolin që luajnë skena dhe personazhet në tregim;</p> <p>1.3. ta kuptojë rolin e hyrjes , brendisë dhe përfundimit në një tregim;</p> <p>1.4. t`i zotërojë rregullat formale</p>

	kujdesin për të mirat e përgjithshme.	hartimi i kopjes përfundimtare.	Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.	të shkrimit të tregimit.
2	-ti njeh hapat e shkrimit të një ritregimi - që me fjalët e tij të ritregojë një pjesë të lexuar; -të ritregojë një fabul, novelë, epope, dramë..... - të ritregojnë me gojë dhe me shkrim ngjarje të përjetuara, vepra të lexuara, emisione televizive dhe filma të shikuar..., duke respektuar rregullat e gramatikës së gjuhës shqipe....	Ritregimi Konceptet: të kuptuarit e temës, diskutimi i ideve, hartimi i tezës filletare, përpunimi i listës, organizimi i paragrafeve, hartimi i skicë-ide-së, përgatitja e kopjes së parë, rishikimi dhe redaktimi, korrigjimi, hartimi i kopjes përfundimtare.	Veprimtaritë: -njohtohen nxënësit me strukturën e ritregimit; -jepen informacione të përgjithshme për karakteristikat e ritregimit dhe kërkohet që të ritregojnë një ngjarje. Temën e zgjedhim ne ose e lëmë që zgjedhjen ta bëjnë vet nxënësit; -ritregimet komentohen. Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.	2.1.të ritregojë duke mbajtur llogari për rregullat formale të ritregimit; 2.2 të dallojë tregimin nga ritregimin; 2.3. të dalloje lloje të ndryshme të ritregimeve.

3	<p>-të dallojë qëllimin e diskutimit; -të kuptojë mënyrën e diskutimit, format dhe idetë e diskutimit; -të dallojë rregullat e diskutimit; -të diskutojnë rrjedhshëm për qëndrimet personale apo të shokëve mbi fenomene dhe ngjarje të ndryshme...; - të shfrytëzojnë fakte dhe argumente gjatë diskutimeve me të njohurit e me të panjohurit; - të referojnë në mënyrë të pavarur mbi ndonjë ngjarje të rëndësishme; - të prezantojnë rrjedhshëm e kuptueshëm (me gojë e me shkrim) fakte të hulumtuara paraprakisht...</p>	<p>Diskutimi</p> <p>Konceptet: të kuptuarit e temës, diskutimi i ideve.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>- sqarohet qëllimi i diskutimit, temat për të cilat mund të diskutohet; -shpjegohet se mund të diskutohet për ide, dilema, mosmarrëveshje, konflikte; - shpjegohet se mund të diskutohet për studime shkencore, zbulime, çështje politike, sociale etj.;; -nxiten nxënësit të diskutojnë në tema të zgjedhura dhe komentohen.</p> <p>- Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>3.1 të diskutojë ide, dilema, probleme, mosmarrëveshje, konflikte; 3.2 të diskutojë ndonjë zbulim; 3.3.ta kuptojë rolin e bashkëbiseduesve në diskutim; 3.4. t`i zotërojë rregullat formale të diskutimit.</p>
4	<p>-të dallojë qëllimin e njoftimit; -të njihet me strukturën e njoftimit, të bazuarit në fakte të sakta; -të bëjnë njoftime me gojë e me shkrim për ngjarje të rëndësishme në punë, në shkollë, në shoqëri...</p>	<p>Njoftimi</p> <p>Konceptet: ngjarje, fakte, shoqëri.</p>	<p>Veprimtaritë</p> <p>-shpjegohet çështje njoftimi, struktura e njoftimit; -jepen shembuj nga njoftime për zbulime shkencore, prova ose eksperimente të ndryshme; - kërkohet nga nxënësit të shkruajnë njoftime dhe të komentohen.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit ; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>4.1.t`i kuptojë rregullat e njoftimit; 4.2 të dallojë strukturën e njoftimit; 4.3. të dallojë lloje të ndryshme të njoftimit; 4.4. të shkruajë njoftim.</p>

5	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajnë tekste për qëllime praktike, të bëjnë hartime të bukura mbi tema të ndryshme...; - të rregullojë një tekst me rend të përmbysur, sipas normave gramatikore...; - t`i njeh hapat e shkrimit, duke filluar nga të kuptuarit e temës. 	<p>Shkrimi</p> <p>Konceptet: të kuptuarit e temës, hartimi i tezës.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -nxënësit njihen me shkrimin e teksteve dhe strukturën e tyre; -jepen informacione për hapat që duhet ndjekur gjatë shkrimit; -kërkohet të ruhet pastërtia e gjuhës; -kërkohet të respektohen rregullat gramatikore. <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit, metoda e krahasimit.</p>	<p>Mxënësi mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> 5.1.të dallojë fazat e shkrimit; 5.2. ta kuptojë rolin që luan gjuha; 5.3. të kuptojë rolin që luan respektimi i normave gramatikore; 5.4. të aftësohet të shkruajë hartime të bukura.
---	--	---	--	---

6	Emërtimi i njësive modulare: Edukim mediatik			
6.1.	<p>Nxënësi do të jetë i aftë:</p> <p>- të krijojë, të shkruajë, të komentojë dhe t'i paraqesë tekstet e veta e t'i botojë në hapësirën mediatike.</p>	<p>Edukimi mediatik</p> <p>- media si gjenerator i perceptimeve, i bindjeve dhe i kulturës së popullarizuar të njerëzve;</p> <p>-transparenca e medias, ndërveprimi me medien – krijo e merr pjesë; komenti, kolumna.</p>	<p>Veprimtaritë</p> <p>Ushtrime e diskutime për informacionet e lexuara, e dëgjua ose të ndjekura të çdo lloj të medias. Simulohet në klasë një medie, shtëpi mediatike dhe sajuhet informacioni /informacionet.</p> <p>Ushtrime rreth shkrimit të komenteve për situata dhe ngjarje të caktuara për të cilat njoftohen aktualisht.</p> <p>Ushtrime për të shkruar kolumna.</p> <p>Metodat: metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e punës me tekst; metoda e komunikimit – monolog/dialog</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>7.1.1: të identifikojë llojet e ndryshme të informacioneve;</p> <p>7.1.2: t'i interpretojë informacionet duke marrë edhe qëndrimin e vet;</p> <p>7.1.3. shkruan një koment/kolumnë për një temë të caktuar – aktuale ose me zgjedhje:</p>
Notimi i të arriturave të nxënësve		<p>Notimi është një proces i vazhdueshëm dhe ka për qëllim të siguron informacione gjithpërfshirëse për të arrituarit e nxënësve dhe njëkohësisht t'i përmirëson të njëjtat, gjegjësisht, përparimi dhe notimi i nxënësve i cili monitorohet në vazhdimësi dhe kryhet në kontinuitet gjatë mësimit dhe nënkupton mbledhjen e rregullt të informacioneve të cilat dokumentohen.</p> <p>Notimi i nxënësve ka për qëllim që tua tregon gjendjen reale të njohurive të tyre dhe t'u jep kahje për përthelimin permanent të mëtutjeshëm. Kriteret për notim arsimtari ua sqaron nxënësve dhe në mënyrë konsistente iu pëmbahe</p>		

	<p>të njëjtave gjatë gjithë vitit shkollor. Instrumentet të cilat kanë të bëjnë me pjesën gojore të notimit dhe vlerësimin të nxënësve mund të jenë me përgjigje të parashtruara nga ana e arsimtarit, pyetje të destinuar para përpunimit të veprës, lektyrës, si dhe përmbajtjeve nga gjuha, prezantime gojore të temave të caktuara, sjelljen e mendimeve dhe qëndrimeve në lidhje me parashtrimin e pyetjeve problemore në vepër dhe lektyre, diskutim për veprat letrare në kontekst shoqëror, historik dhe letrar, detyra shtëpie, aktivite dhe angazhim në orë.</p> <p>Instrumentet për notim me shkrim lidhen me punime me shkrim, me teste objektive të njohurive, të shkathësive, veçanarisht me teste dhe ese të pavarura nëpërmjet të cilave nxënësit do ta zbatojnë të mësuarën përmes shprehjes individuale. Nxënësit për të arriturat e tyre marrin notë numerike.</p>
Literatura dhe burimet tjera	Tekst mësimorë dhe doracak të lejuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime tjera të të mësuarit.
Fillimi i implementimit të Programit mësimor	Viti shkollor 2023/2024
Institucioni/ bartësi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<p>Nënshkrimi dhe data e miratimit të programit mësimor</p> <p>Потпис и датум на донесување на наставната програма</p>	<p>Nr. 13-6691/10</p> <p>Data 4.7.2023</p> <p style="text-align: right;">Ministër Doc. Dr. Jeton Shaqiri</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/>
Data e rishikimit Датум на ревизија	